

FJALA E DEPUTETES MIRELA KUMBARO

E ENJTE 24 NËNTOR 2022

Jemi në një periudhë shumë interesante. Ndërkohë që është fundi i nëntorit, turizmi vazhdon, besoj në mënyrë të kënaqshme për të gjithë, sepse jo vetëm ne, që jemi politikbërës, jo vetëm Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, por i gjithë sektori privat vazhdon të përfitojë, madje e them me shumë kënaqësi që shumë veta nga kjo anë e sallës, që janë në opozitë me qeverinë, konstatojnë sesi ka evoluar turizmi që nga Vlora e deri në lumin e Shalës. Po të shohim shifrat e fundit të INSTAT-it , ku shënohen 6,4 milionë vizitorë të huaj deri në fund të muajit shtator, pra për 9-mujorin e parë, ato janë shumë interesante, sepse praktikisht është numri total i turistëve të huaj që ne i kemi pritur në vitin 2019, që ishte viti më i mirë.

Jo vetëm kaq, por, praktikisht, janë rritur në mënyrë shumë të ndjeshme edhe të dhëna të tjera, për shembull, jo vetëm vizitorët e huaj, por edhe numri i netqëndrimeve për vizitorët, për turistë rezidentë të akomoduar në struktura akomoduese, shkon afërsisht në 1,1 milionë netqëndrime, duke u rritur me 39,1% krahasuar me 9-mujorin e vitit 2019, apo numri i netqëndrimeve për turistët jorezidentë, pra i vizitorëve të huaj të akomoduar, që ka mbërritur vetëm në 9 muajt e parë në 2,2 milionë net, duke u rritur me 24,7% krahasuar me të njëjtën periudhë në vitin 2021. Këto ishin disa nga shifrat e fundit të INSTAT-it, që nuk i përmenda thjesht për të thënë disa shifra, por për të kuptuar flukset turistike të 9-mujorit të parë të këtij viti. Po të shohim numrin e hyrjeve nga deti të vizitorëve të huaj, kemi një rritje prej 93%, që do të thotë se Shqipëria po vizitohet gjithmonë e më shumë nga të gjitha rrugët, ajrore, tokësore dhe detare.

Nuk janë thjesht numra apo indikatorë, janë tregues të rëndësishëm për të kuptuar tendencën e zhvillimit në 5-6 vjetët e fundit, sidomos të viteve që do të vijnë, si dhe për të kuptuar se cila është e ardhmja e Shqipërisë, jo thjesht e ardhmja jonë, por e fëmijëve tanë, që, shkurt, është turizmi, të paktën për këtë biem të gjithë dakord, sikurse e tha pak më parë një koleg, që çfarë vlen për turizëm si investim dhe si politikë, e mbështesim të gjithë, ndonëse ishte nga opozita. Nuk mund të kemi turizëm cilësor dhe konkurrues në Mesdhe, ku ka 100 vjet që bëhet turizëm, nga Mesdheu Jugor e deri tek ai Verior, pa pasur “abc”-në e sektorit portual, aeroportual dhe rrugor. Sektori privat mund të investojë në hoteleri, në agroturizëm, në shërbime, në restorante, të cilat nganjëherë i dëgjoj që i përmendni si me qesëndi, po pra, se ato e bëjnë turizmin: infrastruktura, promovimi dhe shërbimi.

Nëse doni, mund të bëjmë një model edhe më të mirë se ky që kemi ndërtuar për të pasur evente kulturore, atraksione natyrore dhe trashëgimi kulturore, por nuk mjafton për të bërë atë që kemi shpallur si vizion dhe që, të paktën, këtë e ndajmë, që Shqipëria e vitit 2030 të jetë poli qendror i turizmit në Ballkan dhe për këtë mjafton të hedhësh sytë, se modelet i kemi nga Greqia apo nga Mesdheu Jugor në Magreb dhe deri në Francë e në Itali. Në këtë kontekst, projekti i marinës turistike dhe zhvillimi i ballinës ujore të Durrësit janë vizion i së ardhmes së Shqipërisë turistike dhe është, pa dyshim, në nderin tonë sot t'i mbështesim, t'u japim udhë dhe jo vetëm kaq, këtu kemi një model jurisprudence.

Më vjen shumë mirë që kolegë të të gjithë krahëve e kanë lexuar me vëmendje dhe besoj se do të jetë nga ato modele që do t'u shërbejnë juristëve të jashtëm, kur të vijë momenti për të negociuar kontrata të kësaj natyre, që i bëjnë nder shtetit. Është model që nuk e gjeni ende sot në jurisprudencën e negocimit të kontratave, që tregon mënyrën si ndërtohet një marrëveshje ku i jep shtetit rolin kryesor në vendimmarrje, në kontroll dhe në zhvillim. Shënojeni, sepse do të vijë një ditë që do ta kujtoni këtë që po ju them! Të paktën, edhe në këtë kuptim, kemi ndërtuar një model që do të hyjë në historinë e jurisprudencës! Për të ardhur konkretisht tek termat e marrëveshjes, nuk do t'u bëj analizë, sepse u diskutuan kaq gjatë, i keni të shkruar, mund t'u riktheheni, por dua t'i drejtohem opinionit publik.

Janë 800 mijë metra katrorë, pak a shumë, nga të cilat mund të zhvillohen 55% dhe pjesa tjetër i rikthehet Durrësit, madje jo vetëm Durrësit, por edhe Shqipërisë, si pronë shtet e rehabilituar, përfshi edhe plazhin, që sot nuk ekziston, sepse u bë debat i madh edhe për plazhin në verën e shkuar. Në 17% të hapësirës ekzistuese nuk ka fare aktivitet ekonomik, por ka një hapësirë të ndotur, që ndoshta nuk e shohim ose nuk duam ta shohim, sepse përgjithësisht kemi zakonin që, kur është pis, kthejmë kokën nga ana tjetër. Po aty është ajo! E pra, do t'i rikthehet Durrësit si një zonë e gjelbër! E përfiton Durrësi dhe të gjithë turistët që do ta vizitojnë atë. Ne e kemi treguar sesi pisllekun e kthejmë në gjelbërim, madje e kthejmë edhe në hapësirë zbavitjeje, siç e kemi bërë edhe me ekoparkun e gjelbëruar sot në Durrës. 10% e territorit në fjalë përbëhet nga sipërfaqja e infrastrukturës ekzistuese detare, nga kalatat e portit, të cilat nuk do të zhduken, por do të rehabilitohen si port turistik dhe do të mbeten pronë shtet.

Kemi një kanal hyrës prej 5,5 kilometrash dhe 61 hektarë të basenit të portit, që janë prona të vyera shtetërore dhe do të mbeten sërish prona shtet. Marrëveshja nuk parashikon as faljen dhe as shitjen e pronës publike, por parashikon krijimin e një kompanie të përbashkët, ku shteti është aksionar në masën 33%, me të gjitha buzëqeshjet tuaja brenda, dhe, në të parin model të tillë, shteti ka të gjitha benefitet e një aksionari, në të ardhura dhe në fitim, pa pasur asnjë kontribut financiar në zhvillim. Kjo marrëveshje

nuk e kalon tokën në pronësi të privatit, siç ju e shisnit, por e bën atë destinacion zhvillimi dhe rehabilitimi urban, me ndërtesa banimi, me ndërtesa shërbimesh, me hotele, me qendra argëtimi dhe me qendra tregtare, të cilat janë domosdoshmëri, nëse duam të zhvillojmë turizëm dhe nëse duam të mos e lëmë thjesht një territor industrial.

Në fakt, të gjitha janë kërkesa të cilat sot janë nevojë jo thjesht në Durrës, jo thjesht në bregdetin shqiptar, por janë nevojë në detin Mesdhe, sepse kërkesa për të tilla shërbime, kërkesa për marina është rritur shumë më tepër se oferta. Pse të mos e sjellim ne këtë ofertë në Shqipëri? Mbi të gjitha, falë kësaj marrëveshjeje, qeveria nuk shpenzon asnjë qindarkë nga buxheti i shtetit. Investitori privat ka të gjithë barrën dhe përgjegjësinë e financimit në vlerën 2,1 miliardë euro, e shtrirë kjo në 20 vjet. Falë këtij vizioni, kjo marrëveshje materializon një zhvillim të shpejtë, krijon një hartë tjetër ekonomike dhe të ardhurash për të gjithë bregdetin dhe turizmin shqiptar.

Nëse vendet e tjera rreth nesh e kanë nisur zhvillimin e turizmit në shekullin e kaluar dhe sot janë referenca botërore në turizëm, ne nuk mund të presim një shekull për t'i dhënë Shqipërisë atë që na i hoqi historia mizore e komunizmit dhe e komunistëve që, në fakt, nuk e di sesi janë ende këtu mes nesh edhe 30 vjet më pas, atë që na i dha kismet Zoti, duke krijuar këtu një nga pikat më të bukura të Mesdheut, mes detit dhe malit. Pasi jetuam me detin armik për vite dhe dekada të tëra, na u desh një shekull të kuptonim se detin e kemi pasuri dhe mirëqenie dhe, si të tillë, në të ardhmen duhet ta kthejmë edhe në mirëqenie për brezat që vijnë, për Shqipërinë, për Kosovën dhe pse jo për Maqedoninë e Veriut. Këtë duhet ta bëjmë sot, duhet ta bëjmë ne, do ta bëjmë ne, sepse në të kundërt brezat nuk do të na i falin! Faleminderit!